



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

PROCESVERBAL

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 497 Nr. i faq./Br.str./No.pg 153  
Data/Datum/Date 19 / 7 / 24  
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Nga konsultimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore**, i organizuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Sot, **20 qershor 2024**, me fillim nga ora 10:15. Konsultimin e kryesoi kryesuesi i Kuvendit dhe i KPF-së z. **Arbër Zenuni**. Të pranishëm në sallë ishin anëtarët e KPF-së, drejtori i financave z. Afrim Limani, përfaqësuesit e fshatrave, monitoruesit nga OSBE dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.

**Kryesuesi:** Atëherë, përshëndetje për të gjithë! Jemi këtu për konsultimin publik që ka të bëjë me KAB-in. Duke u bazuar në ligjin Nr 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, statutin e Komunës së Rahovecit dhe ligjeve tjera, Komiteti për Politikë dhe Financa në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe me Zyrën për Informim, organizon konsultim publik për KAB-in, 2025-2027. Pa humbur kohë, fjalën ia kalojmë Drejtorit për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani.

**Afrim Limani:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Më lejoni t'i jap disa informata bazë për buxhetin e vitit 2025. Në mes të majit ka ardhur një dokument që quhet Qarkorka e parë (1) buxhetore, ku aty janë përcaktuar limitet dhe tavanet buxhetore për Komunën e Rahovecit për vitin 2025, si dhe projeksionet për vitin 2026-2027. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2025 në total është 20.982.000€. Ky përbëhet nga granti i administratës është 9.168.000€, që ka një rritje prej 681.920€. Buxheti për këshillin e Hoçës së Madhe është 30.970€. Granti i arsimit është 7.330.000€, në krahasim me vitin 2024 ka rritje prej 191.689€. Granti i shëndetësisë: 2.452.200, që në krahasim me vitin 2024 ka një zbritje prej 84.000€. Buxheti në kategori ekonomike përafërsisht do të jetë kështu: Pozicioni i pagave dhe mëditjeve do të jetë 10.552.000, në krahasim me vitin 2024 kemi një rritje prej 125.000€. Mallra dhe shërbime 2.76 1.000, një rritje prej 294.000. Komunalitë mbesin të njëjta prej 390.000. Subvencione kemi 1.010.000 dhe janë të rritura prej 120.000€. Investimet kapitale 6.268.000 dhe që kanë një rritje prej 617.000€. Ky është në total buxheti i Komunës së Rahovecit, për vitin 2025. Në fund e kemi edhe buxhetimin gjinor për gra, që pretendojmë në vitin 2025 të kemi një rritje deri në 55.000€. Jemi duke e pritur edhe qarkoren e dytë (2) buxhetore që mënyrë që ta shohim ku jemi me buxhet preleminar. Këtu jam për çdo pyetje rreth buxhetit, për kërkesat tjera e keni kryesuesin.

**Melinda Iska:** A kemi të drejtë ne si KPF të bëjmë pyetje? Nëse jo, që ka mundësi dikush ta bëjë këtë pyetje: Pse buxheti në shëndetësi ka zbritje?

**Kryesuesi:** Atëherë të gjithë keni të drejtë të bëni pyetje, përveç anëtarëve të KPF-së, sepse takimi është thirrur nga ta.

**Shqipron Berisha:** Përshëndetje! Pse buxheti në shëndetësi ka zbritje?...

**Selman Shtavica:** Jam përfaqësuesi i Hendikosit dhe jam edhe anëtar i këshillit për të drejtat e pacientëve. Kryetarit ia kam parashtruar pyetjen e njëjtë, pse kemi ulje në buxhet të shëndetësisë, ndërkaq, e kemi bërë një hulumtim me qytetarë të Komunës së Rahovecit dhe ka dalur që qytetarët janë të pakënaqur rreth barnave. E dyta, sa do të ketë ndarje të subvencioneve për OJQ-të siç është Hendikosi, qendër kjo e cila është pranë falimentimit. Nuk kemi përkrahje dhe direkt ligjet me buxhetin e shëndetësisë, sepse përmes neve sigurohen karrocet për persona me aftësi të kufizuara, që gjithashtu edhe në këtë pjesë jemi nën zero. Kemi persona që janë të varur nga barnat dhe që nuk guxojnë të mbesin pa barna. Sa mund të na përkrah komuna në këto aspekte?

**Burim Krasniqi:** Kryesues, kondideroj që sot është dashur të jenë të ftuar të gjithë kryetarët e këshillave të fshatrave dhe të lagjeve. Nuk ka logjikë që ata mos të jenë këtu. Buxhetin e komunës nuk e aprovon kryetari, por asambleja, kryetari vetëm e propozon. Unë e di që kërksat janë të mëdha dhe mundësitë e buxhetit janë të kufizuara, por së paku në këtë diskutim publik kanë mundur t'i përmendin prioritetet që i kanë për fshatin apo lagjen e tyre. Kërkoj mirëkuptim që ndoshta në një fazë tjetër kur diskutojmë për buxhet, t'i kërkonim përfaqësuesve të lagjeve dhe fshatrave të jenë prezentë dhe nëse është nevoja sekretaria e kuvendit t'i fton një nga një me telefon. Të jetë diskutim i mirëfillt. Nuk pajtohem me përfaqësimin në këtë sallë.

**Skender Hamza:** Këshillat e fshatrave, zyra për informim i ka ftuar me email dhe me telefon. Ne si sekretari e kuvendit i kemi ftuar OJQ-të, komitetet obligative dhe joobligative, duke iu treguar rëndësinë e këtij takimi.

**Burim Krasniqi:** Për herën tjetër, mund ta dërgojnë një përfaqësues të fshatit, jo medoemos të jetë kryetari i këshillit të fshatit.

**Blerta Gashi:** Përshëndetje për të gjithë! Për hir të korrektësisë, kanë ardhur dy emaila të shprehura në kërkesa prej këshillave të fshatrave. Emaili i parë është nga përfaqësuesi i fshatit Malësi e Vogël, i cili është prezent këtu. Tani do ta lexoj, përfaqësuesi i fshatit Malësi e Vogël – Murat Morina: Si prioritet për banorët e fshatit tonë janë këto projekte për t'u realizuar: Rregullimi i rrugëve publike dhe jopublike me kubëza, 11 rrugë. Rruga “e Varrezave”, rruga “Kosova e re”, rruga “Shpetim Qadraku”, këto janë në projekt, por akoma nuk kanë nisur. Vazhdimi i shtratit të përroit që vjen nga Ratkoci deri te lagjja “Lutfë”. Të futen në projekt kullimi i arave punuese nga reshjet dhe nga ujërat atmosferikë dhe të lidhen me përroit që është te hekurudha dhe të vazhdohet deri të fshati Gexhë-Gradish. Rregullimi dhe vendosja e kanalizimeve të ujërave të zeza në të gjitha lagjet e fshatit. Realizimi i parkut te shkolla fillore “Skender Kastrati”, hapja e rrugëve fushore dhe shtrimi me shavor. Kërkesa e fundit është zgjerimi i ndriçimit në drejtim të fshatit Gexhë. E-maili tjetër është nga fshati Pastasel – Afrim Krasniqi: Kubëzimi i rrugëve të fshatit, afërsisht 1500m. Kubëzimi i stazës deri te lapidari me 2.5 ose 3m gjerësi. Furnizimi me kubëzim 600m<sup>2</sup> për rregullimin e oborrit të odës së fshatit. Rregullimi i dy segmenteve të përrockave, afërsisht 400m. Vazhdimi i trotuarit në lagjen “Mazreku”, afërsisht 300m, vazhdimi i ndriçimit publik në rrugën kryesore, afërsisht 400m dhe në disa pjesë ku shtyllave u mungon ndriçimi. Bartja dhe rregullimi i kanalizimit me sistem të mbyllur në dy segmente nga vendi që derdhen ujërat e zeza, afërsisht 800m. Rregullimi i dy rrugëve fushore, njëra 1900m dhe tjetra 800m. Mirëmbajtja e dy rrugëve fushore ekzistuese, si dhe dy hapësira gjelbëruese – dy parqe.

**Artan Asllani:** Përshëndetje për të gjithë! Jam Artan Asllani, përfaqësues i fshatit Drenoc. Në emër të banorëve të fshatit Drenoc edhe unë i kam disa kërkesa, të njëjtat janë të dorëzuara me protocol në drejtoritë përkatëse. Në fshatin Drenoc ka kërkesa elementare, ne e kuptojmë që K.R.U Gjakova është përgjegjës për furnizimin dhe mirëmbajtjen e ujit, mirëpo është jetik dhe pa të nuk mund të jetohej. Kërkoj nga e ekzekutivit dhe anëtarëve të KPF-së, që të bëhet një zgjidhje rreth ujit të pijes, çoftë me participim përmes KRU-së apo ministries. Me të vërtetë është thatësi e madhe dhe furnizimin e bëjmë me puse. Kemi ende rrugë të pakubëzuar, në mes të qendrës në fshat dhe rrugë të tjera gjithsej 10 rrugë. Si shqetësim tjetër është rruga prej Rahovecit e deri në Sarosh.

**Mehreme Gërguri Krasniqi:** Koordinator e projektit “Kontrata Sociale” që do të implementohet në Komunën e Rahovecit nga USAIDI. Kjo kontratë ka për qëllim që t'i asistoj zyrtarët komunalë që të jenë më të përgatitur për pjesëmarrjen publike me qytetarë dhe të komunikojnë sa më shumë me ta. Kemi filluar zbatimin e kontratës sociale dhe javën e ardhshme e kemi edhe një punëtor me zyrtarët komunalë. Kontrata sociale ka për qëllim që vlerësimin e kërkesave të cekura në këtë mbledhje.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Pjesëmarrës të nderuar! Pajtohem me parafolësin që sot është dashur të jenë më shumë anëtarë të kuvendit t'i dëgjojnë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të komunës. Kjo pjesëmarrje është shqetësuese. Kryesisht, unë di të parashtoj kërkesa jo vetëm prej lokalitetit nga vij, por për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit. Shërbimet publike - kryesisht nevojat esenciale, kanalizim dhe ndriçimi publik, të trajtohen me prioritet nëpër territorin e komunës.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! Të nderuar të pranishëm dhe kolegë anëtarë të KPF-së. Meqenëse kryesuesi nuk e dha një sqarim në fillim, duke mos e treguar përgjegjësinë tonë në këtë cikël buxhetor. Ne jemi këtu vetëm për t'i dëgjuar kërkesat e qytetarëve që janë prezentë dhe atë kërkesa që qytetarët i drejtohen institucioneve me shkrim apo përmes e-mailave. Në rolin e implementimit e buxhetit roli i anëtarëve të kuvendit është i vazhdueshëm dhe ne e monitorojmë këtë proces prej Qarkores së parë buxhetore, dëgjimet buxhetore deri te miratimi i buxhetit dhe implementimin e tij. Kërkesat e juaja, përveç që i shqyrtojmë, i kujtojmë edhe gjatë seancave të kuvendit. Kjo është forma më e mirë e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen e qeverisjes lokale, ashtu siç parashihet sipas ligjit.

**Xhabir Hajrullaga:** Jam përfaqësues i lagjes 1 (qendra në Rahovec). Kam një kërkesë për nderimin e rrugës "Halil Hamza" që lidhet me rrugën "Kuvendi i Ladhës" dhe duke pasur parasysh që së paku 5 herë kemi bërë kërkesë pranë jush. Deri më tani nuk është marrë asnjë iniciativë për riparimin e asaj rruge. Rruga në fjalë është e ndërtuar me kubëza rreth viteve të 80-ta, nuk ka kanalizim e as ndriçim. Aty ka banorë të konsiderueshëm që jetojnë. Disa herë kanë qenë edhe banorët personalisht këtu për këtë kërkesë të tyre.

**Burim Krasniqi:** E kam një kërkesë për drejtorin e financave. Drejtor, kërkesat i keni të protokoluara edhe me shkrim. Meqenëse jemi me një fazë më të hershme, kërkesa ime si anëtar i KPF-së dhe si shef i grupit të asambleistëve të LDK-së, defakto si përfaqësues i LDK-së, kërkesat të na përcillen në email, para se të vij draft-buxheti. I kuptoj rrethanat në të cilat gjendet komuna e Rahovecit, për shkak të obligimeve të mëdha që i ka dhe për shkak të kontratave të nënshkruara deri tani. Kërkoj mirëkuptimin dhe nëse mendoni ta keni votën e të gjithë asambleistëve, përveç kërkesave të lagjeve, fshatrata dhe të OJQ-ve që na dërgoni, jepni edhe një prioritetizim të projekteve. Ta kemi një listë të projekteve të zotuar. Konsideroj që buxheti duhet të votohet në mënyrë unanime nga të gjithë asambleistët, por, kjo mund të bëhet kur asambleistët e dinë qartë se çka janë duke votuar.

**Afrim Limani:** Faleminderit kryesues! Format i këtij takimi është që ju anëtarët e KPF-së jeni nikoqirë. Burim, është dashur të uleni këtu përpara, por e keni mësuar atë vend shumë mirë, e "inshallah" edhe një mandat aty. E vërtetë është që i kemi regjistrimet e të gjitha dëgjimeve buxhetore dhe sipas mundësive tona i fusim në buxhet. Te pyetja se pse ka buxhet më pak te granti i shëndetësisë: E vërtetë që 84.000€ janë më pak dhe besoj shumë që është gabim teknik, i cili mund të përmirësohet në Qarkoren e dytë buxhetore. Me këtë gabim këtu, gjithashtu mungojnë edhe 9 vende pune në shëndësi. Selman, buxhet për barna esenciale do të jetë me patjetër. Shtëpia e Hendikosit shumë shpejt do të fillojë të rinovohet. Paraprakisht mendoni dhe përgatiteni një projekt për këtë kategori, sepse jemi duke menduar ta fusim në buxhet.

**Selman Shtavica:** Përshëndetje Afrim, faleminderit! Unë kam biseduar edhe me kryetarin dhe e kam vërtetuar që për barnat në QKMF nuk varet prej komunës. Gjatë anketimeve në fshatra dhe qytete kemi dalur shumë poshtë me vlerësim të qytetarëve. Të kënaqur për barna kanë qenë 32%.

**Defrim Kafexhiu:** Në cilësinë e anëtarit të kuvendit, po e bëj një pyetje: Ju si kryesues, në listën e OJQ-ve përfituese të subvencioneve, sidomos te Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe e Arsimit te bursat, t'i publikoni OJQ-të përfituese dhe vlerat e përfituara.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, nëse nuk keni diçka tjetër, duke iu falënderuar për vëmendje shihemi në mbledhje të radhës.

Procesmbajtësi:

